



Të nderuar kolegë dhe lexues të RSK-së,

Me kënaqësi të veçantë ju drejtohem si kryeredaktore e Revistës së Stomatologëve të Kosovës (RSK), në prag të botimit të numrit të shtatë, që shënon vëllimin e katërt të kësaj reviste shkencore.

Numri më ri i Revistës Stomatologjike të Kosovës përmban punime shkencore dhe profesionale që reflektojnë zhvillimet bashkëkohore në stomatologji, si dhe përkushtimin e autorëve për avancimin e dijes dhe praktikës klinike. Në këtë botim paraqiten raste dhe studime të rëndësishme si: fibrosarkoma anaplastike e nofullës së poshtme përmes një rasti klinik të dokumentuar, efikasiteti i fibrinës së pasur me trombocite në kombinim me graftin sintetik në rigjenerimin e defekteve infrakockore parodontale, ndikimi i olanzapinës në homeostazën kockore në një hulumtim paraklinik, si dhe qasjet moderne në rehabilitimin protetik të dimensionit të humbur vertikal dhe kafshimit të kryqëzuar anterior. Ky numër karakterizohet edhe nga bashkëpunimi ndërkombëtar me autorë nga Kroacia, të cilët kontribuojnë me tri punime me rëndësi: menaxhimin e emergjencave mjekësore në ordinancat dentare, rrjetet e ofrimit të shërbimeve në mjekësinë dentare si bazë për funksionim të suksesshëm të sistemit shëndetësor oral, si dhe përdorimin e teknologjisë CAD/CAM në punimin e urave nga zirkoni – një temë që pasqyron integrimin e inovacionit digjital në protetikën moderne. Në fund të këtij botimi, sjellim edhe një portret të shkurtër të profesorit Agim Islami, si nderim për kontributin e tij të çmuar në arsimin dhe zhvillimin e stomatologjisë në vendin tonë.

Ftoj të gjithë profesionistët, studiuesit dhe akademikët e fushës së stomatologjisë që të kontribuojnë me punimet e tyre shkencore dhe profesionale në numrat e ardhshëm të revistës, në mënyrë që të vazhdojmë së bashku këtë rrugëtim zhvillimi dhe bashkëpunimi profesional. Në emër të Redaksisë, shpreh mirënjohje të thellë për autorët, recenzentët dhe të gjithë bashkëpunëtorët.

Në nemër të Redaksisë, Ju dëshirojmë një lexim të këndshëm dhe motivues për punën tuaj profesionale dhe shkencore!

Prof. Ass. Donika Bajrami-Shabani,
Kryeredaktore e RSK-së.